REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASENIT UJOR SEMAN**

ZYRA E ADMINISTRIMIT TE BASENIT UJOR SHKUMBIN-SEMAN
Nr. 130 Prot.
Datë.më 3. 3. 2022

# VENDIM

**Nr.3, datë 24.02.2022**

**PËR**

## MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR UJË TË PIJSHËM TË BASHKISË KUÇOVË, ME VENDNDODHJE, BASHKIA KUÇOVË, QARKU BERAT

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50,të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Seman,

**V E N D O S I:**

Miratimin e kërkesës për leje, për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor për ujë të pijshëm të Bashkisë Kuçovë me vendodhje: Bashkia Kuçovë, Qarku Berat.

1. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Burimi i Sinecit

Vendodhja e burimit ujor (KRGJSH) Burimi i Sinecit

-X= 501821.5; Y= 4522880.4; Z=218 m.m.n.d

Sasia e ujit që jepet për përdorim
-Q=17.69 l/s

Prurja mesatare vjetore
-Q=60 l/s

2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**LEFTER SHEHAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I BASENIT UJOR - SEMAN